

*Specialist në Sektorin e Koordinimit, në Drejtorinë e GIS-it Kombëtar dhe Gjeoportalit,
në Autoritetin Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor*

Në zbatim të Ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995, të Kodit të Punës së Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar, Ligjit nr. 72/2012 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë”, Vendimit nr. 147, datë 20.2.2013, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor””, të ndryshuar dhe Urdhrit të Kryeministrit nr. 121 datë 31.07.2018 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Autoritetit Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor”, Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor shpall konkurrimin për 1 (një) vend të lirë pune në pozicionin:

- **Specialist në Sektorin e Koordinimit, në Drejtorinë e GIS-it Kombëtar dhe Gjeoportalit, në Autoritetin Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor**

DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË E POZICIONIT PËRMBAJNË POR NUK KUFIZOHEN NË:

1. Përgjigjet për bashkerendimin institucional lidhur me nismat dhe projektet e autoriteteve përgjegjëse në fushën e gjeoinformacionit dhe merr pjesë në grupet e punës për shqyrtimin e tyre.
2. Administron informacionin Gjeohapësinor dhe metadatat e publikuara në Gjeoportalin Kombëtar nga autoritetet publike sipas temave të parashikuara në ligjin 72/2012.
3. Përgjigjet për sigurinë dhe mirëfunksionimin e sistemit IT të institucionit.
4. Përgjigjet për mirëmbajtjen dhe zhvillimin e faqes zyrtare të Web-it ASIG.
5. Përgjigjet për mirëmbajtjen, zhvillimin dhe back up e sistemit softwerik të Gjeoportalit Kombëtar dhe moduleve të sistemeve GIS & IT që lidhen me të.
6. Përgjigjet për referimin e çdo problematike të identifikuar gjatë procesit të punës dhe bën rekomandimet përkatëse.

KËRKESA TË PËRGJITHSHME PËR KANDIDATËT

- Të zotërojë diplomë të nivelit Master Profesional në Inxhinieri Kompjuterike / Teknologji Informacioni.
- Të ketë të paktën 1 (një) vit eksperience pune;
- Të ketë njohuri në rjetet kompjuterike, Linux, Kali Linux, etj.
- Të ketë njohuri të gjëra në programet: Java, CTT, Web Design, Pythom, etj.
- Të ketë njohuri të gjëra në Database.
- Të ketë njohuri të gjëra në Rrjetet dhe Sigurinë Kibernetike.
- Të ketë eksperiencë në zhvillimin e sistemeve të konfigurimit, IT si dhe platformave dhe aplikacioneve të bazuar në GIS.

- Të ketë aftësi të mira komunikimi, propozimi dhe menaxhim projektesh si dhe aftësi të mira raportimi.
- Të ketë përvojë në administrimin e bazave të të dhënave gjeografike (spatial database).
- Të jetë njohës i mirë i gjuhës angleze dhe njohja e gjuhëve të tjera është prioritet.
- Vlerësohen certifikimet për sa më lart.

PAGA PËR POZICIONIN ËSHTË NË KATEGORINË (IV-a)

PARAQITJA E DOKUMENTEVE:

Kandidati duhet të dërgojë brenda datës 10.02.2023, në Autoritetin Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor në adresën: Rruga “Papa Gjon Pali II”, Nd. 2, H.3, Kati 2, Tiranë ose në adresën e e-mailit info@asig.gov.al, këto dokumente:

- Kërkesë për aplikim
- CV
- Fotokopje të diplomës dhe listës së notave
- Fotokopje të librezës së punës
- Fotokopje të certifikatave të kualifikimit (nëse ka)
- Fotokopje të dëshmive të gjuhëve të huaja
- Vërtetimin e gjendjes gjyqësore
- Të paktën një letër rekomandimi
- Një numër telefoni si dhe adresën e plotë për t’u kontaktuar

Mosparaqitja e plotë dhe brenda afatit e dokumenteve sjell skualifikim të kandidatit.